

# STATUTI

## I

### SHOQERISE TREGTARE

#### “RIVIERA PARAFABRIKAT” shpk

Sipas Legjislacionit shqiptar, Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit”, une,

- **z. Agim Kola**, i datelindjes 10/08/1977, lindur ne Bajram Curri, Tropoje, dhe banues ne Lezhe, me adrese: Mylte, Nd.111,H.1, Shenkoll, Gryke-Lumi, 4511, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, shtetas shqiptar, mbajtes i Kartes se Identitetit me Nr. Personal H70810037E,

Ortak i Shoqerise “RIVIERA PARAFABRIKAT” shpk, krijuar sipas Aktit te Themelimit, me vullnet te lire e te plote miratova Statutin e shoqerise “RIVIERA PARAFABRIKAT” shpk

### KREU I

#### Neni 1

#### Emertimi i shoqerise

Emertimi i shoqerise eshte : “RIVIERA PARAFABRIKAT” shpk.

Shoqeria “RIVIERA PARAFABRIKAT” shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar ( me poshte e quajtur shoqeria).

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te Statutit te saj dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit”

#### Neni 2

#### Personaliteti Juridik

Shoqeria eshte shoqeri tregtare e themeluar nga “Ortaku i Shoqerise”, i cili pergjigjet ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

Shoqeria “RIVIERA PARAFABRIKAT” shpk eshte nje e tille, kapitali i se ciles ndahet ne kuota dhe qe themelohet nga Ortaket e shoqerise qe perballojne humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne Kapitalin Themeltar.

#### Neni 3

#### Selia

Selia e Shoqerise “RIVIERA PARAFABRIKAT” shpk eshte ne adresen:

**Lezhe, Mamurras, Fushe-Mamurras, Autostrada Tirane-Lezhe, Kurbin.**

Shoqeria ne baze te legjislacionit mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve te shoqerise ne perputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do te hapen.



Neni 4  
Objekti i Aktivitetit

Shoqëria **“RIVIERA PARAFABRIKAT” shpk** është krijuar për të realizuar veprimtari private në këto drejtime:

- Prodhimi në mënyrë industriale i elementeve parafabrikat me beton normal, të armuar dhe të parandëruar, transporti dhe montimi i tyre në veper. Punime strukturore speciale, në terrene jo rezistente dhe të deformueshme, ndërtim me pilota, mure mbajtëse etj. punime për shtresa dhe mbistruktura speciale, punime në impiante teknologjike, termike, punime në impiante të linjave telefonike dhe telekomunikacionit, punime topogjeodezike, punime për mbrojtjen ndaj zhurmave dhe ndikimit në infrastrukture, punime gjeologjike.
- Punime në rrugë, autostrada, ura, punime nëntokësore dhe vepra arti, punime ndërtimi kanalizime të ujërave të zeza dhe të bardha, punime ndërtimi ujësjellëse, ndërtim porte, Kalata dhe të gjithë Infrastrukturen që ka lidhje me këto punime, punime në vepra arti, diga , tunele, punime ndërtimi në vepra kullimi dhe vaditje, punime ndërtimi për mbrojtje lumore, sisteme hidraulike, bonifikime, ndërtim argjinatura, punime të inxhinierisë mjedisore, punime për prishjen e ndërtimeve, comtim impiantesh
- Punime për impiantet hidrosanitare, punime për impiantet ngritëse dhe transportuese, punime rifinitura të ndryshme, me material druri, plastik, metalik, xhami apo rifinitura të tjera teknike, punime suvatimi, bojatisje etj, punime të sinjalistikës ndricuese dhe jo ndricuese, punime ndërtimore për barrierat rrugore.
- Shfrytëzim, prodhim, import, eksport, të materialeve inerte, gure gelqeror, betoni dhe asfaltobetoni. Punime germimi në toke, punime ndërtim civile dhe industriale, mirëmbajtje, ristrukturime, veshje fasadash.
- Shërbime në fushën e: Projektim, ndërtim dhe operim i H.E.C-ve, ku përfshihet ndërtimi, venia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike.
- Prodhimi i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, nëpërmjet energjisë diellore, sistemet fotovoltaike
- Transporti i dherave, inerteve dhe mbetjeve të perziara nga ndërtimi dhe prishjet.
- Riciklim i gomave të përdorura dhe materialeve plastike nëpërmjet impiantit të pirolizës.
- Projektim dhe ndërtim i magazinave dhe dhomave frigoriferike për grumbullimin, seleksionimin, ruajtjen dhe eksportin e fruta-perimeve.
- Grumbullim, paketim, tregtim, ruajtje, eksport & import fruta-perimesh.
- Shërbime në fushën e Hoteleri & Turizem, Bar, Restorant, Agjensi Udhetimi, shitje biletash etj.
- Shërbime Marketingu për çdo lloj produkti e materiali, etj.
- Shoqëria mund të kryejë edhe veprimtari të tjera ndihmëse të cilat mbështesin arritjen e qëllimit të saj kryesor në përputhje me legjislacionin në fuqi.



**Neni 5**  
**Kohezgjatja e Shoqerise**

Kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise **“RIVIERA PARAFABRIKA”** **shpk** do te jete per nje periudhe kohe te pa percaktuar, me perjashtim te rasteve kur mbaron sipas parashikimeve ne ligj ose kur vendos asambleja e ortakeve. Ky afat fillon me rregjistrimin e shoqerise ne Rregjistrin Tregtar.

**KREU II**  
**KAPITALI**

**Neni 6**  
**Kapitali Themeltar dhe Kontributet**

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 ( njeqindmije ) leke

Kapitali Themeltar eshte i ndare ne 1 Kuote.

Ortaku i shoqerise **z. Agim Kola** zoteron 1 (nje) kuote qe eshte 100% e te gjithë vleres se kapitalit, me vlere totale prej 100.000 (njeqindmije) leke.

Pjesa e kapitalit themeltar perfaqeson kontribute ne para dhe eshte shlyer plotesisht nga ortaku i shoqerise, i nevojshem per veprimtarine e shoqerise.

Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne shoqerine tregtare do te shenohet edhe kapitali i shoqerise i derdhur nga ortaku i saj.

Rritja e kapitalit te shoqerise nga ortaku nuk eshte e kufizuar.

**Neni 7**  
**Menyrat e fitimit dhe kalimi i kuotave**

Kuotat e kapitalit dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te perfitohen ose mund te perfitohen ose mund te kalojne nepermjet:

- Kontribut ne kapitalin e shoqerise
- Blerja dhe shitja
- Trashegimia
- Dhurimi
- Cdo menyre tjeter e percaktuar ne ligj.

**Neni 8**  
**Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet , me vendim te marre prej  $\frac{3}{4}$  nga Asambleja e Ortakeve. Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te pjeseve te reja, ortaket kane te drejten e perparemise ne nenshkrim, proporcionalisht me shumen e pjeseve te tyre, e drejte nga e cila ata mund te heqin dore.

Kapitali Themeltar i shoqerise mund te zvogelohet me vendim te marre nga  $\frac{3}{4}$  e Asamblese se Ortakeve. Zvogelimi i kapitalit i prek te gjithë ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe ata perfaqesojne.



**Neni 9**  
**Transferimi i Kapitalit**

Pjeset e Kapitalit Themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve dhe te transferueshme ne rruge trashegimie. Trashegimtari, paraardhesi ose passardhesi behen ortake nepermjet transferimit te pjeseve te Kapitalit Themeltar.

Pjeset e Kapitalit Themeltar mund te transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, me vendim te marre me shumicen e ortakeve qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te Kapitalit Themeltar.

Ne rast se njeri ose disa nga ortaket deshirojne te transferojne pjeserisht ose plotesisht, pjeset qe ata zoterojne ne Kapitalin Themeltar tek te tretet, me pare duhet qe oferta per shitje tu behet ortakeve te tjere te shoqerise, me te njejtat kushte qe do t'i behet te treteve.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emri i administratoreve, si dhe emri i Ortakeve duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen rreth saj.

**Neni 10**  
**Organel e Shoqerise**

Organel e shoqerise jane:

1. Asambleja e Ortakeve
2. Administratori

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore. Asambleja e Ortakeve te shoqerise drejton procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnje kufizim.

**Neni 11**  
**Kompetencat e Asamblese se Ortakeve**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Per menyren e drejtimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, ajo shprehet me vendime per gjithshka qe eshte ne kompetencat e saj te pershkruara si me poshte:

- Ortaket perballojne humbjet e shoqerise vetem deri ne kufirin e vleres qe ata kane kontribuar ne Kapitalin Themeltar.
- Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe vendimet e Asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarta me pjeset e Kapitalit Themeltar qe ai zoteron. Ne ushtrimin e se drejtes se tij per te marre pjese ne vendimet kolektive, cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje ortak tjeter, ose nga bashkeshorti apo nje person tjeter i zgjedhur prej tij, me kusht qe keta te jene autorizuar me prokure.
- Cdo ortak ka te drejta te barabarta ne menaxhimin e aktivitetit te shoqerise. Pa dakortesine te gjithe ortakeve nuk do te kryhen veprime te tilla si: marrja dhe



dhenia e huave (kredive), ekzekutimi i ndonje marreveshjeve sigurie, pengu, obligacione, nuk perpilohen, dorezohen apo pranohen asnje leter komerciale, kontrate qiraje apo shitje/blerje per pasurite e shoqerise apo per llogari te saj, pervec llojit te prones se blere apo te shitur ne rjedhen normale te biznesit te saj.

- Mbledhja e Asamblese mund te kerkohet nga nje ose disa ortake qe zoterojne mbi 1/10 e pjeseve te Kapitalit Themeltar, nga administratoret, nga ekspertet kontabel te autorizuar, po qe se ka te tille ose nga likuiduesi. Lajmerimi per mbledhjen e Asamblese behet nga administratoret.
- Sipas rendesise se vendimeve, mbledhja e Asamblese mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme. Asambleja e zakonshme vendos per ceshtje si: percaktimin e politikave tregtare te shoqerise, emerimi ose shkarkimi i Administratoreve, zevendesit, ekspertet dhe revizoret kontabel dhe percakton shperblimin per ta, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogarite vjetore si dhe ben ndarjen e fitimit.
- Asambleja e zakonshme ne mbledhjen e pare mund te marre vendime te vlefshme ne qofte se jane te pranishem ose te perfaqesuar nje numer ortakesh qe zoterojne mbi 1/2 e pjeseve te Kapitalit Themeltar dhe vendimet merren nga ortaket qe perfaqesojne mbi 1/2 e pjeseve te kapitalit. Ne qofte se mbledhja e pare e Asamblese se zakonshme nuk realizohet, thirret mbledhja e dyte e cila mund te marre vendime te vlefshme, me miratimin e shumices se ortakeve qe kane qene te pranishem pavaresisht nga numri i pjeseve te Kapitalit Themeltar qe ato zoterojne.
- Asambleja e jashtezakonshme vendos per ceshtje te tilla si ndryshimi i statutit, zvogelimi dhe zmadhimi i Kapitalit Themeltar, transferimi tek te tretet, zgjatja e e kohes se veprimtarise se shoqerise apo likuidimi i saj, shnderrimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri te formave te tjera etj, si dhe cdo ceshtje tjeter qe parashikohet ne ligj.

## **Neni 12** **Administrimi**

Shoqeria mund te administrohet nga nje ose me shume administratore qe mund te jene persona te zgjedhur brenda bashkesise se ortakeve ose jashte saj.

Asambleja e Pergjithshme e shoqerise mund ta shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

Administratori emerohet per nje periudhe 5- vjecare me te drejte riperseritje, me perjashtim te rastit te doreheqjes ose te shkarkimit te parakoheshem para mbarimit te afatit.

## **Neni 13** **Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka te drejte:

- Te beje rregjistrimin e shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit.
- Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfaqeson shoqerine perpara te gjithe personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve (institucioneve) shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritet gjyqesore te te gjitha



shkalleve. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise. Administratori angazhon shoqerine ne marredhenie me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Te drejte te nenshkruaje kontrata te ndryshme ne emer e per llogari te Shoqerise, perfshi ketu kontratat e qirase, shitjes, blerjes a hipotekimit te pasurive te paluajtshme, te nenshkruaje aktet e themelimit te shoqerive te tjera ku Shoqeria eshte ortak, te nenshkruaje e hartoje cdo dokument e te kryeje ne emer te Shoqerise cdo veprim perballe te gjitha Bankave shqiptare apo te huaja ne lidhje me celjen apo mbylljen e llogarive rrjedhese te Shoqerise.

- Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e ortakeve ne realizimin e veprimeve te posacme e me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare. Te kujdeset per mbajtjen ne menyre te sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise. Te beje te mundur pergatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe te nenshkruaje bilancin vjetor te mbyllur, per t'u miratuar nga Asambleja e Ortakeve brenda dates 20 Mars te vitit te ardhshem dhe raportin e ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve. Te kryeje rregjistrimin dhe publikimet e detyrueshme te te dhenave te shoqerise.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin se administratori e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti qe kufizojne kompetencat e administratorit, te cilat rrjedhin nga ky nen, duhet te respektohen nga te tretet.

#### **Neni 14** **Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja e Ortakeve qe i sjell dem shoqerise, i ngarkohen administratorit qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale pasojat perkatese.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket kane te drejte te ngrejne padi penale kunder tij.

Ortaket kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Ortaket qe nuk jane administrator, kane te drejte ne cdo kohe te informohen personalisht per veprimtarine e shoqerise dhe te njihen me llogarite dhe dokumentet e shoqerise.



**Neni 15**  
**Emerimi i Pare i Administratoreve**

Administrator i shoqerise eshte:

- **z. Agim Kola**, i datelindjes 10/08/1977, lindur ne Bajram Curri, Tropoje, dhe banues ne Lezhe, me adrese: Mylte, Nd.111,H.1, Shenkoll, Gryke-Lumi, 4511, shtetas shqiptar, mbajtes i Kartes se Identitetit me Nr. Personal H70810037E, per nje periudhe 5-vjecare, me te drejten e riemerimit.
- Administratori i shoqerise do te ushtroj kompetencen e vet ne kete detyre per nje periudhe 5- vjecare sipas ligjit, me te drejten e riemerimit dhe ngarkohet te beje regjistrimin e kesaj shoqerie prane Qendres Kombetare te Biznesit.

**Neni 16**  
**Marredheniet e punes**

Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

**Neni 17**  
**Konfidencialiteti, Ruajtja e sekretit**

Ortaket e shoqerise si dhe personat e tjere te pranuar ne kete shoqeri bien dakort qe te mos i ekspozojne asnje personi te jashtem informacionet qe disponon shoqeria, kontrata qe ajo do te lidhe, cdo lloj materiali, si dhe planet dhe qellimet qe ajo ka per te ardhmen e shoqerise, pra konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet.

**Neni 18**  
**Dokumentat e destinuar per te tretet**

Te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxirren nga shoqeria dhe qe jane te destinuar per te tretet, si letrat, faturat, lajmerimet, publikimet e ndryshme etj., duhet te tregojne lexueshem emrin e shoqerise si dhe pas fjalet " Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose inicialet "SH.P.K" si dhe emrin e administratorit.

**KREU IV**  
**VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMIT**

**Neni 19**  
**Viti financiar**

Viti Financiar i shoqerise fillon ne 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor te secilit vit.



**Neni 20**  
**Bilanci i Shoqerise dhe Caktimi i Fitimit**

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne date 31 dhjetor te cdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Asambleja e Ortakeve me vendimin e ortakeve qe zoterojne mbi 1/2 e pjeseve te Kapitalit Themeltar. Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, mbledhja e Asamblese se Ortakeve ben miratimin e dokumentave mbi veprimtarine vjetore. Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve, Asambleja e Ortakeve percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividenteve mbi fitimin proporcionalisht me perqindjen e pjesmarrjes se gjithesecilit ne shoqeri. Fitimi qe do te ndahet ndermjet ortakeve ne propocion me pjeset e Kapitalit Themeltar, perbehet nga fitimi i vitit financiar te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem (5 % e fitimit te cdo viti, deri sa ky fond te arrije 1/10 e Kapitalit Themeltar) dhe nga ana tjeter i jane zbritur ose i jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.

**Neni 21**  
**Librat e shoqerise**

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec librit te shoqerise, ne te cilin shenohen emrat e plote te ortakeve te shoqerise, kapitali themeltar, vendimet e marra nga asambleja e ortakeve si dhe dokumentacionin kontabel dhe librat e tjere.

**Neni 22**  
**Ekspertet Kontabel te Autorizuar**

Ne rast nevoje si dhe kur kerkohet nga ligji, kontrolli kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per dy vite financiare me mundesi rizgjedhjeje nga ortaket qe perfaqesojne 1/2 e Kapitalit Themeltar.

Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi i tij, ne rast se verehen gabime, abuzime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko- tregetare te shoqerise, ate gjithhevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar nga Asambleja e Ortakeve dhe e ka kryer nje gje te tille.

Ne perfundim te kontrollit Eksperti Kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te Bilancit Financiar Vjetor si dhe per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ia paraqese e dorezoje ne kohe Asamblese se Ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe kane.



## **KREU V** **PRISHJA DHE NJOFTIMET**

### **Neni 23** **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, edhe para plotesimit te afatit per te cilen eshte krijuar sic mund te jene:

- Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj.
- Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare ".
- Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Shoqeria nuk priset kur njeri prej ortakeve falimenton, behet i paafte ose vdes, por vazhdon aktivitetin me ortaket e tjere qe kane mbetur si dhe me trashegimtarete e radhes se pare te ortakut qe vdes, pasi ata jane te miratuar me pare nga Asambleja e Ortakeve sipas shumices se votave te percaktuar ne nenin 8 te Statutit.

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja emeron nje likuidues, i cili i paraqet asaj raportin e likuidimit dhe te dhenat mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likuidimit Asambleja vendos me vendimin e ortakeve qe zoterojne te pakten ¾ e Kapitalit Themeltar, mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likuiduesit dhe per mbylljen e procesit te likuidimit.

Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te Kapitalit Themeltar tek kontribuesit perkates, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakeve propocionalisht me pjeset qe ato zoterojne ne Kapitalin Themeltar.

### **Neni 24** **Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

### **Neni 25** **Dispozitat e pergjithshme**

Persa eshte shprehur ne kete Statut i referohemi Ligjit 9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregtetaret dhe Shoqerite Tregtare ", Ligjit 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ", Legjislacioni tjetere ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

## **Emri dhe nenshkrimi i Ortakut Themelues** **te Shoqerise Tregtare "RIVIERA PARAFABRIKAT" shpk**

Agim KOLA



Tirane, me 04.09.2023